



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ .2024

VENDIM

Nr. 140, datë 13.03.2024

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KRITEREVE
LIGJORE TË KANDIDIMIT NË PROCEDURAT E LËVIZJEVE PARALELE
NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM TIRANË E DURRËS, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 73,
74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86 DATË 20.02.2024 TË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 13.03.2024, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, 86 datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, si dhe pasi shqyrtoi propozimin përkatës,

VËREN

I. Mbi procedurat e lëvizjes paralele në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë e Durrës të shpallura me vendimet nr. 73- nr. 86, datë 20.02.2024 Këshillit të Lartë Gjyqësor.

1. Në Mbledhjen Plenare të datës 20.02.2024, në ushtrim të funksionit kushtetues dhe ligjor për të siguruar mbarëvajtjen dhe administrimin e pushtetit gjyqësor, por edhe përgjegjësisë për të siguruar pavarësinë dhe përgjegjshmërinë e tij, me vendimet nr. 73; 74; 75; 76; 77; 78; 79; 80; 81; 82; 83; 84; 85 dhe 86 datë 20.02.2024 Këshilli i Lartë Gjyqësor hapi procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë e Durrës.

2. Për procesin e lëvizjes paralele, si një nga format e transferimit të magjistratit, janë parashikuar rregulla që adresojnë si nevojat e sistemit të drejtësisë, ashtu edhe të drejtën e magjistratit për ecurinë në karrierë. Bazuar në parimet e parashikuara në nenin 42, ligjvënësi ka synuar që nëpërmjet rregullave kryesisht procedurale në nenin 43, të garantojë qartësi dhe parashikueshmëri për transferimin e magjistratit në procedurën e lëvizjes paralele, si një nga mjetet standarde të lëvizjes së gjyqtarëve brenda të të njëjtit nivel.
3. Afati i kandidimit për këto procedura të lëvizjes paralele si më lart u përcaktua deri më datë 01.03.2023.
4. Brenda afatit të kandidimit u paraqitën gjithsej **39 (tridhjetë e nëntë)** kandidatura, të cilët kanë aplikuar në procedurat e lëvizjes paralele për pozicionet e lira fushën civile e penale në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë dhe **20 (njëzet)** kandidatura, të cilët kanë aplikuar në procedurat e lëvizjes paralele për pozicionet e lira fushën civile e penale në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Durrës të prezantuar si më sipër, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

II. VLERËSIMI I KËSHILLIT

5. Lidhur me verifikimin e kandidatëve që kandidojnë për lëvizjen paralele, Këshilli ka miratuar procedura të detajuara përmes Vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”. Pikërisht, në respektim të këtij rregulli, Këshilli duhet të disponojë për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 73; 74; 75; 76; 77; 78; 79; 80; 81; 82; 83; 84; 85 dhe 86, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
6. Në Kreun IV të vendimeve respektive nr. 73 - nr. 86 datë 20. 02. 2024, Këshilli ka përcaktuar procedurën përkatëse që do të ndiqet si më poshtë:

“IV. Procedura e lëvizjes paralele

8. *Procedura e lëvizjes paralele zhvillohet në tre faza, si më poshtë:*
 - a) *në fazën e parë bëhet verifikimi i kandidatëve për plotësimin e kriterëve ligjore të kandidimit;*
 - b) *në fazën e dytë bëhet renditja e kandidatëve të kualifikuar;*
 - c) *në fazën e tretë merret vendimi për transferimin e kandidatit të renditur më lart.*
9. *Pas përfundimit të afatit të kandidimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli miraton me vendim listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, të atyre që kanë ose mund të kenë një vlerësim, si dhe të kandidatëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.*

10. Pas vendimit të Këshillit sipas pikës 9, fillon faza e parë e procedurës së lëvizjes paralele, ku kandidatët që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, i nënshtrohen fillimisht procesit të verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 5, të këtij vendimi, proces ky që realizohet sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”...

7. Këshilli, me vendimin nr.127, datë 11.03.2024 Këshilli ndër të tjera ka vendosur: “Miratimin e listës së gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 73; 74; 75; 76; 77; 78; 79; 80; 81; 82; 83; 84; 85 dhe 86, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas Shtojcës I bashkëngjitur këtij vendimi”.

SHTOJCA I

Lista e gjyqtarëve që kanë 2 (dy) vlerësime:

1. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;
2. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;
3. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;
4. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;

Lista e gjyqtarëve që mund të kenë 2 (dy) vlerësime:

1. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;
2. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër/ aktualisht i caktuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ;
3. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;
4. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier/ aktualisht i caktuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;

5. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
6. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
7. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës/ aktualisht komanduar pranë Shkollës së Magjistraturës;
8. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër;
9. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;

8. Në këto kushte, në përputhje me pikën 9 të vendimeve, nr. 73-nr.86 datë 20.02.2024, vendimin nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” të Këshillit, Komisioni i propozon Këshillit të miratojë projektvendimin për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 73; 74; 75; 76; 77; 78; 79; 80; 81; 82; 83 dhe 85, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë dy vlerësime.

9. Sa i përket kandidatit z. {...}, siç rezultojn edhe nga prezantimi në shtojcë ai është aktualisht gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së parë JP Tiranë. Kërkesa e tij për transferimin nëpërmjet lëvizjes paralele bie në kundërshtim me parimet dhe kuptimin e transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele sipas Nenit 42 e 43 të Ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” si edhe rregullores 320/2020, për arsyet që do të argumentohen më poshtë:

9.1 Kuptimi i transferimit jepet në nenin 42 të Ligjit 96/2016. Sipas parimeve të transferimit të parashikuara në këtë nen, vërehet se 1. “Transferimi” është: a) lëvizja në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nga një pozicion në një gjykatë ose prokurori në një pozicion në një **gjykatë ose prokurori tjetër** të të njëjtit nivel; b) caktimi nga një pozicion i komanduar në një pozicion në gjykatë ose në prokurori, i cili është në të njëjtin nivel me pozicionin e mëparshëm; c) caktimi nga një pozicion i komanduar në një pozicion në gjykatë ose në prokurori të shkallës së parë, nëse magjistrati nuk ka pasur pozicione të mëparshme.

9.2 Z. {...} ka kandiduar për tu transferuar nëpërmjet lëvizjes paralele në pozicionin 81 të fushës penale në Gjykatën e Shkallës së Parë JP Tiranë, duke qenë gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë JP Tiranë, i cili e ushtron funksionin aktualisht në seksionin civil të kësaj gjykate. Pra z. {...} nuk ndodhet në kushtet e germës “a” të Nenit 42 të Ligjit 96/2016 për të lëvizur në një gjykatë tjetër. Ndërsa në germën “dh” të pikës 6 të rregullores 320/2020 parashikohet se: “6. Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: ...dh) “Lëvizje paralele” nënkupton kalimin e gjyqtarit: i) nga një pozicion në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm ose administrativ në një

pozicion në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm ose administrativ të të njëjtit nivel". Kandidimi i z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë JP Tiranë, seksioni civil për në Gjykatën e Shkallës së Parë JP Tiranë, seksioni penal nuk mund të jetë objekt i lëvizjes paralele dhe të rregullohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

10. Lidhur me znj. {...}, kandidatë e identifikuar si gjyqtare e cila mund të ketë 2(dy) vlerësime Këshilli vlerëson se ndaj saj nuk mund të fillojë procedura e verifikimit për lëvizjen paralele pasi kjo gjyqtare nuk ka aplikime të vlefshme.
11. Këshilli ka verifikuar kriteret formale për kandidaten z. {...} për pozicionet nr. 500/2022 dhe nr. 501/2022 për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; këto dy aplikime znj. {...} i ka ende në proces; gjithashtu znj. {...} ka aplikuar edhe për pozicionin nr. 246/2023 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe këtë aplikim e ka ende në procedurë pasi është duke u verifikuar për kriteret formale.
12. Neni 43/5 i Ligjit 96/2016 parashikon se: *“Pas shpalljes së procedurës së lëvizjes paralele, magjistrati mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të lira, që janë në proces. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë. Magjistrati që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës.”* Ndërsa Neni 48/6 parashikon se: *“Pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, magjistrati mund të kandidojë për jo më shumë se tri pozicione të lira, që janë në proces. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë. Magjistrati që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës.”*
13. Duke mbajtur në konsideratë parashikimet ligjore të mësipërme, për këtë kandidatë me më tepër se 3(aplikime), qofshin këto për ngritje në detyrë dhe/ose lëvizje paralele të vlefshme do të konsiderohen ato të bëra më parë në kohë. Në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë do të vlefshme do të konsiderohen ato kandidime që janë renditur sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura nga Këshilli, duke filluar nga ai i shpalluri më parë. Neni 43/5 dhe neni 48/6 i Ligjit 96/2016 kanë përcaktuar numrin maksimal të kërkesave që mund të paraqesin kandidatët magjistratë në procesin e shpalljes së pozicioneve të lira nga KLGJ, qofshin këto pozicione në procedurat e lëvizjes paralele, apo në procedurat e ngritjes në detyrë. Procesi i shpalljes së pozicioneve të lira nga KLGJ në procedurën e lëvizjes paralele si dhe në procedurën e ngritjes në detyrë është një proces që jo detyrimisht është i ndarë nga njëri – tjetri në funksion të kandidatit. Kandidati është i lirë dhe nuk kufizohet nga ligji për të kandiduar në të njëjtën kohë si në procedurat e lëvizjes paralele, ashtu edhe në procedurat e ngritjes në detyrë. I

vetmi kufizim ligjor¹ i përcaktuar nga nenet 43/5 dhe neni 48/6 i Ligjit 96/2016 është numri i pozicioneve të lira në proces për të cilat kandidati paraqet interesin e tij. Magjistrati mund të kandidojë në një proces që përfshin procedurat e lëvizjes paralele dhe/ose procedurat e ngritjes në detyrë për jo më shumë se 3 (tri) pozicione të lira. Pra znj. {...} aplikime të vlefshme ka ato të ngritjes në detyrë për pozicionet nr. 500/2022 501/2022 dhe 246/2023 dhe për të nuk do të fillojë procedura e verifikimit të kriterëve ligjore për lëvizjen paralele pasi nuk ka pozicione të vlefshme në garë. Ajo nuk mund të kandidojë për më shumë se 3 (tri) pozicione të lira.

14. Në arritjen e këtij konkluzioni Komisioni ka mbajtur në vëmendje edhe qëndrimin Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 00-2020-995, datë 28.12.2020, ku arsyetohet se: “...68. *Kjo mënyrë konceptimi nga ana e ligjit e mundësisë për kandidim merr vlerë dhe relevancë juridike, në rastet kur vendet e shpallura vakante janë më shumë se tre dhe se të gjitha eventualitetet e këtij lloji paraqesin një vëllim pune të shtuar dhe të konsiderueshëm për Këshillin e Lartë Gjyqësor. Për rrjedhojë, ligji përmes këtij kufizimi ka kërkuar të mos ngarkojë procedurën e ngritjes në detyrë, ku konkurrimi mund të rezultojë fiktiv, në kushtet e përzgjedhjes së tyre si gjyqtarë në gjykatën me juridiksion lëndor të posaçëm apo më të lartë. Kjo do të thotë se ligji ka synuar të shmangë situatat e pakufizuara të kandidimeve fiktive apo të pafrytshme dhe të ushtruara nga kandidatët thjeshtë dhe me qëllimin e vetëm për të shtuar mundësitë dhe probabilitetin e suksesit në procedurën e ngritjes në detyrë. Përmes këtij kufizimi, ligji ka dashur të ndërrojë gjëja dhe të bëjë kandidatët konkurrues të përgjegjshëm për rëndësinë e vendimmarrjes së tyre në iniciativën e ushtrimit të kërkesës për kandidim në pozicionet e shpallura të lira dhe të hapura për garë nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

69. *Kjo do të thotë se përzgjedhja e interpretimit më të pranueshëm të nenit 48, pika 6 të Ligjit nr. 96/2016 do të duhet të bëhet sipas kriterit që nuk prevalon vetëm interesin e kandidatit për t'u ngritur detyrimisht në detyrë dhe për të shtuar probabilitetin e zhvillimit të karrierës së tij/saj, por do të duhet të bëhet sipas konkluzionit që arrin të mbrojë edhe interesin publik të mirëadministrimit të procedurës plurale të ngritjes në detyrë që zhvillon Këshilli i Lartë Gjyqësor. Për rrjedhojë. Kolegji konkludon se interpretimi sipas të cilit neni 48, pika 6 të Ligjit nr. 96/2016 lejon kandidatët të konkurojnë për më shumë se tre pozicione vakante për ngritjen në detyrë nuk pajtohet me të gjitha kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës, pasi mohon qëllimet ligjore për mirëadministrimin e proceseve të ngritjes në detyrë të magjistratëve prej Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

70. *Në këtë mënyrë, Kolegji vlerëson se Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Gjykata Administrative e Apelit kanë respektuar nenin 17 të Kushtetutës në mënyrën se si kanë interpretuar nenin 48, pika 6 të Ligjit nr. 96/2016 dhe se interpretimi rishtazi i kësaj dispozite nuk është bërë në mënyrë të papritur, të paaksesueshme dhe të paparashikueshme për palën rekursese. Për rrjedhojë, paditësi nuk është vënë para efektit surprizë të vendimmarrjes administrative apo gjyqësore.*

¹ Termi “kufizim ligjor” është referuar në paragrafin 71 të vendimit nr. 00-2020-995 datë 28. 12. 2020 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

71. Kolegji vlerëson se ky interpretim ligjor përbën kufizim me ligj dhe nuk cenon në thelb të drejtën e paditësit për tu promovuar. Nisur nga kjo analizë kushtetuese e interpretimit të nenit 48, pika 6 e Ligjit nr. 96/2016, në raport edhe me nenin 43/5 të Ligjit, nuk ka rëndësi nëse gjyqtari kandidon për gjykata të ndryshme apo brenda të njëjtës gjykatë apo edhe në të njëjtën fushë të së drejtës, pasi ky kufizim duhet të zbatohet, në çdo rast, për qëllimet e mbarëvajtjes së proceseve paralele administrative dhe prurale të ngritjes në detyrë.”

15. Lidhur me kandidatin z. {...}, i identifikuar si kandidat i cili mund të ketë 2(dy) vlerësime, edhe ai ndodhet në kushtet kur ka më tepër se 3(tre) kandidime të vlefshme në proces. Z. {...} është në garë në pozicionin nr.14/2023 në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë dhe për të ka filluar procedura e verifikimit të kriterëve ligjore për dy pozicione në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm që janë pozicionet nr. 244 dhe nr. 246.
16. Për këtë kandidat me më tepër se 3(aplikime), qofshin këto për ngritje në detyrë dhe/ose lëvizje paralele të vlefshme do të konsiderohen ato të bëra më parë në kohë. Në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë të vlefshme do të konsiderohen ato kandidime që janë renditur sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura nga Këshilli, duke filluar nga ai i shpalluri më parë. Pra z. {...} aplikime të vlefshme ka ato të ngritjes në detyrë për pozicionet nr. 244/2023, nr. 246/2023 dhe pozicionin nr.14/2023 për lëvizjen paralele në Gjykatën Shkallës së Parë të JP Tiranë të shpallur më parë. Si konkluzion, për të nuk do të fillojë procedura e verifikimit të kriterëve ligjore për lëvizjen paralele pasi ky kandidat nuk ka pozicione të vlefshme në garë. Për këtë kandidat vlen argumentimi në pikat 12-14 të këtij vendimi.
17. Kandidatja {...} ka më tepër se 3(tre) aplikime në proces. Konkretisht ajo ka aplikuar në pozicionet nr.74, 82, 83, 84. Për arsyet e përmendura më sipër për këtë kandidate do të fillojë procedura e verifikimit vetëm për 3 (tre) kandidimet e vlefshme nr. 74, 82 dhe 83.
18. Gjithashtu, edhe kandidati Nertil Dushku ka aplikuar në më shumë se 3(tre) pozicione, konkretisht, nr. 75, 76 dhe 77 në Gjykatën e Shkallës së Parë JP Tiranë dhe nr. 83 dhe 84 në Gjykatën e Shkallës së Parë JP Durrës. Kandidime të vlefshme të këtij kandidati do t'i konsiderohen ato nr. 75, 76 dhe 77.
19. Në pozicionet nr. 84 dhe nr. 86 që i përkasin Gj Shkallës së Parë JP Durrës vërehet se nuk ka në garë kandidatë që kanë ose mund të kenë 2(dy) vlerësime. Për rrjedhojë për këto pozicione Këshilli duhet të vijojë me verifikimin për kandidatët me 1 (një) vlerësim.
20. Në Kreun IV të vendimeve respektive nr. 84 dhe nr. 86 datë 20.02.2024, Këshilli ka përcaktuar procedurën përkatëse që do të ndiqet si më poshtë:

“IV. Procedura e lëvizjes paralele

9. Procedura e lëvizjes paralele zhvillohet në tre faza, si më poshtë:

- a) në fazën e parë bëhet verifikimi i kandidatëve për plotësimin e kriterëve ligjore të kandidimit;*
- b) në fazën e dytë bëhet renditja e kandidatëve të kualifikuar;*

c) në fazën e tretë merret vendimi për transferimin e kandidatit të renditur më lart.

11. Pas përfundimit të afatit të kandidimit sipas pikës 3 të këtij vendimi, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli miraton me vendim listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, të atyre që kanë ose mund të kenë një vlerësim, si dhe të kandidatëve që nuk kanë dhe nuk mund të kenë asnjë vlerësim.

12. Pas vendimit të Këshillit sipas pikës 9, fillon faza e parë e procedurës së lëvizjes paralele, ku kandidatët që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, i nënshtrohen fillimisht procesit të verifikimit të plotësimit të kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 5, të këtij vendimi, proces ky që realizohet sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”.

13. Në rast se për pozicionin e lirë nuk ka kandidatë që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale, ose kur kandidatët e kësaj kategorie tërhiqen nga kandidimi, ose kur ata nuk kualifikohen për mosplotësim të kriterëve të kandidimit, procedura e lëvizjes paralele vazhdon për kandidatët që kanë apo mund të kenë një vlerësim etik dhe profesional. ...”

21. Këshilli, me vendimin nr.127, datë 11.03.2024 Këshilli ndër të tjera ka vendosur: “Miratimin e listës së gjyqtarëve **që kanë ose mund të kenë një vlerësim**, për efekt të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 73; 74; 75; 76; 77; 78; 79; 80; 81; 82; 83; 84; 85 dhe 86 datë 20.02.2024, sipas Shtojcës II bashkëngjitur këtij vendimi”

SHTOJCA II

Lista e gjyqtarëve që kanë 1 (një) vlerësim:

1. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.
2. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Lista e gjyqtarëve që mund të kenë 1 (një) vlerësim:

1. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, aktualisht e komanduar pranë Gjykatës së Lartë;
2. Z.{...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;

3. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
 4. Z.{...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër/ i caktuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
 5. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, aktualisht komanduar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
 6. Z.{...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
 7. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës;
 8. Z. Enkel Peza, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë;
 9. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat;
 10. Z.{...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;
 11. Z.{...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës;
 12. Z.{...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, aktualisht në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut;
 13. Z.{...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;
 14. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat;
 15. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
 16. Znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
 17. Z.{...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë/ i caktuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
 18. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier/ aktualisht e komanduar pranë Gjykatës së Lartë;
 19. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë/ e caktuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
 20. Znj.{...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.
 21. Z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë/ caktuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
 22. Z.{...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;
22. Nga lista e gjyqtarëve të përfshirë në Shtojcën II, rezulton se 6 (gjashtë) prej tyre kanë kandiduar në pozicionet nr. 84 dhe nr.86.

Përkatësisht, **në pozicionin nr. 84:**

- {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Në pozicionin nr. 86

- {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;
- {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier;
- {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë;
- {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë/ i caktuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;
- {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;
- {...}, gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë/ caktuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

23. Për sa më sipër, për kandidatët e përmendur në pikën 22 të këtij vendimi do të fillojë procedura e verifikimit të kriterëve ligjore në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 84, dhe 86 datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si kandidatë që kanë ose mund të kenë 1(një) vlerësim.

PËR KËTO ARSYE

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 86, shkronja “ç”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 8, pikat 2 dhe 3, nenin 43 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun IV dhe V të vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, pas shortit të hedhur,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82,83 dhe 85, datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2(dy) vlerësime.
2. Caktimin e relatorit si më poshtë:
 1. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro;
 2. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Alban Toro;

- | | |
|------------------------------|-------------------------------|
| 3. Për kandidatin z. {...} | - relator z. Klodian Kurushi; |
| 4. Për kandidaten znj. {...} | - relator z. Klodian Kurushi; |
| 5. Për kandidatin z. {...} | - relator z. Klodian Kurushi; |
| 6. Për kandidatin z. {...} | - relator z. Klodian Kurushi; |
| 7. Për kandidaten znj. {...} | - relator z. Markelian Koça; |
| 8. Për kandidatin z. {...} | - relator z. Markelian Koça; |
| 9. Për kandidaten znj. {...} | - relator z. Alban Toro; |
| 10. Për kandidatin z. {...} | - relator z. Alban Toro; |

3. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Durrës, të shpallura me vendimet nr. 84, dhe 86 datë 20.02.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 1(një) vlerësim.

4. Caktimin e relatorit si më poshtë:

- | | |
|------------------------------|-------------------------------|
| 1. Për kandidatin z. {...} | - relator z. Markelian Koça; |
| 2. Për kandidatin z. {...} | - relator z. Markelian Koça; |
| 3. Për kandidaten znj. {...} | - relator z. Klodian Kurushi; |
| 4. Për kandidatin z. {...} | - relator z. Klodian Kurushi; |
| 5. Për kandidatin z. {...} | - relator z. Alban Toro; |
| 6. Për kandidatin z. {...} | - relator z. Markelian Koça; |

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR